



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



PROGRAMI I LËNDËS:

GJUHË FRËNGE 3

Ngarkesa: ECTS, 40 orë seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti II /semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim/ B

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Ky modul synon të zhvillojë kompetencat gjuhësore, leksikore, komunikative dhe kulturore të studentëve përmes studimit të teksteve të ndryshme dhe analizës gjuhësore. Mësimdhënia bazohet në një qasje ndërvepruese, duke trajtuar në mënyrë të ekuilibruar të kuptuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit, si edhe duke nxitur reflektimin dhe ndërjegjësimin ndërkulturor përmes dokumenteve autentike.

Objektiva specifike lëndore:

-Të thellojë dhe të përmirësojë njohuri thelbësore të strukturave gjuhësore të gjuhës frënge në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar dhe saktësuar specifikat fonetike;
-Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës, si dhe shumë strategji të të nxënit që do të çojnë progresivisht drejt autonomisë gjuhësore;
-Të zhvillojë aftësitë për të zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat, për të argumentuar, shpjeguar dhe arsyetuar opinionet, debatet, projektet dhe veprimet në mënyrë koherente për të folur për veprimtaritë dhe zakonet, për të përshkruar, për të krijuar marrëdhënie, për të hyrë në jetën aktive përmes studimit dhe punësimit, për të ndërvepruar, për të shprehur dëshirat, për të analizuar e argumentuar, për të mobilizuar dhe për t'u përfshirë në aksione të karakterit shoqëror.

Rezultate të pritshme:

- Të kuptojnë pikat kryesore të një diskutimi kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të njohura në punë, shkollë, kohë të lirë etj.;
- Të jetë autonom në shumicën e situatave që hasen gjatë udhëtimit në një rajon ku flitet gjuha e synuar;
- Të jetë në gjendje të prodhojë një ligjërim të thjeshtë dhe koherent për tema të njohura dhe në fushat e tij të interesit;
- Të dijë të tregojë një ngjarje, një përvojë ose një ëndërr, të përshkruajë një qëllim dhe të shpjegojë shkurtimisht arsyet ose shpjegimet për një projekt ose një ide.